

1	Baza për opinion	<p>Hortikultura gjatë vitit 2019 ka pranuar nga komuna e Prishtinës pajisje për shfrytëzim në vlerë prej 595,170€¹. Gjatë shfrytëzimit të këtyre pajisjeve rrjedhin përfitime ekonomike në drejtim të ndërmarrjes, këto pajisje ndërmarrja i kishte të regjistruar në regjistrat e saj kontabël, por pa ndonjë vlerë monetare. Si rezultat i regjistrimit të tyre pa vlerë monetare, pasuritë afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar janë nënvlerësuar për vlerën e lartshënuar.</p> <p>Regjistrimi i këtyre pajisjeve pa vlerë monetare në regjistrat kontabël ishte bërë për shkak se sipas marrëveshjes së pranim-dorëzimit të tyre, të njëjtat do të regjistroheshin në regjistra kontabël të komunës së Prishtinës.</p>	<p>Bordi i drejtorëve të sigurojë se marrëveshja me komunën e Prishtinës korrigjohet, ku do të parashihet se pajisjet të dhëna në shfrytëzim nga komuna regjistrohen në regjistrat kontabël të Kompanisë me vlera të sakta siç parashihet me kërkesat e kornizës konceptuale të raportimit financiar dhe të standardeve të kontabilitetit.</p>	<p>Ndërmarrja do të marrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi ku do të organizohen takime me aksionarin në mënyre që ta zgjidhim qështjen e këtyre pasurive me marrëveshje të shkruar që të regjistrohen në regjistrat kontabël të Kompanisë me vlera të sakta siç parashihet me kërkesat e kornizës konceptuale të raportimit financiar dhe të standardeve të kontabilitetit., apo ti mbaj Aksionari në rexhistrat e veta.</p>	Bordi i Drejtorëve-Kryesuesi i Bordit	<p>01 tetor 2020</p> <p>31 janar 2020</p>	
---	------------------	---	--	---	---------------------------------------	---	--

2	Baza për opinion	<p>Hortikultura po ashtu gjatë vitit 2018 kishte pranuar nga komuna e Prishtinës disa pajisje të punës (dy kamion, dy traktor dhe një cisternë) dhe disa pajisje tjera, vlera e të cilëve nuk dihej me saktësi, dhe në vitet 2013-2017 kishte pranuar pajisje dhe makineri me vlerë prej 512,772€, të cilat i kishte regjistruar pa vlera monetare në regjistrat e saj kontabël dhe rrjedhimisht në pasqyrat e saj financiare është nënvlerësuar pasuria afatgjatë.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se këtij procesi nuk i kishte paraprirë një dokumentim (marrëveshje), ku do të specifikoheshin obligimet dhe të drejtat e të dyja palëve, por vetëm një proces i pranimit dorëzimit të këtyre pasurive jo qarkulluese.</p>	Bordi i drejtorëve të sigurojë së procesi i pranimit të pasurive nga komuna e Prishtinës bëhet duke i paraprirë një marrëveshje e cila specifikon obligimet e palëve dhe prezanton qartë vlerën e pasurive të pranuar. Po ashtu, pasuritë e pranuar të viteve të mëhershme dhe pajisjet të regjistruhen në vlerën e saktë të tyre sipas kërkesave të kornizës raportuese të kontabilitetit.	Ne do të drejtohem Aksionarit që ta marrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi ku përpos pranimit të hartohet edhe marrëveshja e cila i specifikon obligimet e palëve dhe prezanton qartë vlerën e pasurive të pranuar.	Bordi i Drejtorve-Kryesuesi i Bordit	01 tetor 2020 31 janar 2020	
3	Pasuritë	Komisioni i inventarizimit të pasurisë i cili ishte themeluar nga Kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes kishte dorëzuar raportin e vet pa shënime mbështetëse.	Bordi i drejtorëve të sigurojë që komisioni i inventarizimit në raportin e vet të evidentoj asetet	Në themelimin e komisionit për inventarizime të cilat do të formohen për inventarizimin e	Zyrtari për financa dhe Thesar	31 dhjetor. 2020	


		<p>Nuk ishin mbajtur shënime mes gjendjes faktike/fizike të aseteve dhe regjistrit për të vërtetuar ekzistencën e aseteve. Në raport të këtij komisioni ishte identifikuar lloji dhe viti i prodhimit po jo edhe sasia e asetit. Poashtu komisioni nuk kishte konstatuar se cilat asete janë dëmtuar apo janë nxjerrë jashtë përdorimit.</p> <p>Mungesa e njohurive nga komisioni i inventarizimit për kompletimit e procesit të inventarizimit si dhe mos harmonizimi i shënimeve për sasinë e aseteve ishte shkak i mangësive të identifikuar.</p>	<p>sipas sasisë, numrit identifikues, të konstatoj se a janë ende në përdorim apo janë të dëmtuar si dhe në fund të konstatoj nëse ka ndonjë diferencë eventuale në mes librave kontabël dhe gjendjes faktike.</p>	<p>mjeteve në fund vit do të informojm edhe me shkresë të veçantë lidhur me procesin e inventarizimit të mjeteve duke i informuar me obligimet të cilat i kanë si komision</p>			
4	Të hyrat/faturimi	<p>Hortikultura kryen shërbime për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe parqeve bazuar në kontratën mes saj dhe komunës së Prishtinës. Në faturën e muajit prill ndërmarrja kishte faturuar komunën e Prishtinës për shërbimet e kryera sipas kontratës dhe me këtë rast</p>	<p>Bordi i drejtorëve duhet të siguroj se faturimet bëhen konform kushteve të kontratës dhe për furnizimet të cilat janë të liruara nga TVSH të mos aplikohen normat</p>	<p>Me rastin e këtij rekomandimi në gjatë vitit do të rishikojm fatuarat e faturuara nga faturisti në mënyrë që pozicionet e specifikuar të jenë në harmoni me ligjet e aplikueshme që në të ardhmen</p>	Zyrtari për financa dhe Thesar	01.shtator. 2020 31.dhjetor. 2020	

		<p>kemi vërejtur se tek pozicioni i mbjelljes dhe kultivimit të luleve në hapësirat publike Hortikultura kishte aplikuar TVSH-në, gjersa ky pozicion ishte i përjashtuar nga TVSH-ja (pra ishte pozicion i tatueshëm me 0%), efekti financiar i këtij pozicioni në këtë faturë ishte 6,578€ i cili iu kishte faturuar komunës pa bazë të qëndrueshme.</p>	e TVSH-së.	mos të persëriten gabimet e njejta.			
5	Shpenzimet	<p>Analizat tona tregojnë se ekzistojnë diferenca ndërmjet të dhënave kontabël dhe pasqyrave financiare gjegjësisht tek zëri i shpenzimeve administrative të cilat në kontabilitet ishin prezantuar me vlerë 103,692€ ndërsa në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshurë ishin prezantuar në vlerë 102,463€, pra janë nënvlerësuar shpenzimet në vlerë 1,229€.</p>	<p>Bordi i drejtorëve të siguroj se me rastin e përpilimit të pasqyrave financiare përfshihen të gjitha kodet e shpenzimeve në mënyrë që të dhënat kontabël të jenë të paraqitura drejtë dhe saktë në pasqyra financiare.</p>	<p>Zyra e financave do të marrë hapat e nevojshme që në përpilimin e pasqyrave financiare të përfshihen të gjitha kodet e prezentuara të shpenzimeve që të dhënat kontabël të jenë të paraqitura drejtë dhe saktë në pasqyra financiare. në rexhistrimin</p>	Zyrtari për financa dhe Thesar	31. dhjetor 2020	

6	Rekrutimi	<p>Konkursi i shpallur më 13.05.2019 për plotësimin e vendeve të lira të punës: për 5 vozitës, 1 komercialist, 2 kryepunëtor në mirëmbajtjen e gjelbërimit, 5 punëtor në mirëmbajtjen e gjelbërimit, 5 kultivues të luleve në sera dhe 1 punëtor në porto arkë, rezultuan me parregullsi si në vijim:</p> <p>Kompania në konkursin publik nuk kishte përcaktuar fare kohëzgjatjen e kontratës;</p> <p>Komisioni përzgjedhës ishte themeluar 19 ditë nga dita e publikimit të konkursit, pra me 16 dite vonesë;</p> <p>Komisioni përzgjedhës nuk kishte përpiluar listën e aplikuesve që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit;</p>	<p>Bordi i drejtorëve të siguroj se në të gjitha proceset e rekrutimit, zbatohen në përpikëri të gjitha procedurat dhe udhëzimet të cilat e rregullojnë procesin e rekrutimit, në mënyrë procesi të jetë sa më transparent dhe konkurrues, duke krijuar mundësinë e përzgjedhjes së kandidatëve më meritor.</p>	<p>Duke u bazuar nga rekomandimi i dhënë nga , zyra kombëtare e auditimit, pas shqyrtimit të kësaj pike do të kërkohet nga zyra përkatse që t'i njoftoi organet e caktuara se mbi cilolen bazë ligjore duhet të punohet në mënyrë që përmes interpretimeve të mos ketë lëshime procedurale në procedurat e rekrutimit.</p>	<p>Sekretari i përgjithshëm i kompanis</p>	<p>31. dhjetor 2020</p>	
---	-----------	--	---	--	--	-------------------------	--

Kryesuesi i Bordit të Drejtorve

z. Shpëtim Aliu


 PRISHTINE
 SH.A. D.T.C.

Date: 17.08.2020